



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 564/22
Datë/Datum. 22. 11. 2022
PRISHTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ i Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 564/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Agon Ramadani - Referues, Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "EL BAU" SH.P.K- Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr "Skenderbeu, Bekim Zenuni dhe, Mursel Hyseni" me nr. të prokurimit: VU644-22-8086-5-2-1 (Lot 1), iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Vushtrri, me datën 22.11.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **Mbetet në fuqi**, anulimi i aktivitetit të prokurimit: "Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr "Skenderbeu, Bekim Zenuni dhe, Mursel Hyseni" me nr. të prokurimit: VU644-22-8086-5-2-1 (Lot 1), iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Vushtrri.

II. Lejohet kthimi i tarifës së sigurimit të ankesës, obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 29.09.2022, Autoriteti Kontraktues – Komuna Vushtrri ka publikuar Njoftimin për anulim lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr "Skenderbeu, Bekim Zenuni dhe, Mursel Hyseni" me nr. të prokurimit: VU644-22-8086-5-2-1 (Lot 1).

Me 20.10.2022 OE "EL BAU" SH.P.K- Gjilan ka parashtruar ankesë me (Nr. protokoll: 564/22), kundër njoftimit të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkësë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 08.11.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

- Ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Të anulohet vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Duke analizuar me kujdes lëndën në fjalë dhe sqarimet e ofruara nga ana e Autoritetit kontraktues konstatoj se pretendimi ankimor i palës ankuese është i bazuar pjesërisht. Duke marrë për bazë edhe komunikimin me autoritetin kontraktues nga ana e ekspertit shqyrtues, konsideroj se anulimi i kësaj procedure është bërë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik, konkretisht nenin 62 i LPP-së, neni 44.5, 44.6 të RRUOPP).

Në bazë të pyetjeve të bëra në adresën e Autoritetit kontraktues nga ana e ekspertit shqyrtues dhe komunikimeve në përgjithësi, dhe pamundësisë së dëshmisë nga ana e autoritetit që gabimi ka ndodhur në paramasa të dëshmohet atëherë kjo krijon një paqartësi nga ana e autoritetit kontraktues, dhe si rrjedhojë e kësaj rekomandoj kthimin në rivlerësim të kësaj dosje te tenderit.

Kërkesa e ekspertit për autoritetin kontraktues ashtu siç e kam specifikuar edhe me lartë në këtë raport ka qenë se të dëshmohet paramasa që ka ekzistuar pikërisht për dosjen e tenderit që aktualisht është përshkrimi. Kjo nuk është dokumentuar dhe si rrjedhojë len të kuptohet se nuk ka mundësi te iniciohet, aprovohet një procedurë e prokurimit pa pasur fillimisht përcaktimin e paramasave për atë dosje te tenderit.

Gjithsesi në të ardhmen gjatë rivlerësimit i mbetet autoritetit kontraktues ta dëshmoj të kundërtën e kësaj, duke ofruar dëshmi te mjaftueshme për gabimin që pretendohet qe ka ndodh ne dosjen e tenderit.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Duke analizuar me kujdes lëndën në fjalë dhe sqarimet e ofruara nga ana e Autoritetit kontraktues konstatoj se pretendimi ankimor i palës ankuese është i bazuar pjesërisht. Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me ligjin e prokurimit duke tejkaluar afatin e paraparë për përgjigje në

kërkësën për rishqyrtim nga ana operatorit ekonomik, pa ofruar ndonjë dëshmi shtesë për zgjatjen e afatit te paraparë. Me këtë rast bie ndesh me nenin 108/ A par.6 të LPP-së dhe nenit 6.3 të Rregullores për parashtrimin e ankesave.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankesës të aprovohet pjesërisht si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit te prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Me datë 08.11.2022, raporti i ekspertit shqyrtues është dërguar tek të dyja palët, me ç'rast nuk kemi pranuar deklarimin e palëve në procedurë lidhur me pajtimin ose mos pajtimin me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konstaton se në publikimin e këtij aktiviteti të prokurimit është bërë një gabim ku AK ka publikuar gabimisht paramasën dhe parallogarinë për një rrugë tjetër e cila nuk është e përfshirë në këtë Dosje të Tenderit këtë e ka konstatuar edhe eksperti shqyrtues në ekspertizën e tij, dhe si rezultat i këtij gabimisht e kanë plotësuar OE. Është e vërtet se këtë gabim AK ka qenë dashtë me vërejte me kohë, gjithashtu edhe OE kanë qenë dashtë me pas reagim për këtë, por ky gabim ka rrjedh dhe asnjëra palë nuk e kanë vërejtur deri në këtë fazë, andaj PSH konsideron se janë përbushur kushtet e nenit 62 të LPP-së për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit sepse është e pamundur të vazhdohet dhe të nënshkruhet kontrata për një aktivitet të prokurimit me titull “*Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr “Skenderbeu, Bekim Zenuni dhe, Mursel Hyseni”*”, i cili ka një paramasë dhe paralogari tjetër për LOT 1 “*Ndërtimi i rrugës me kubëza betoni “Brukselli”*” dhe për LOT 2 “*Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni “Segmenti i rrugës Bekim Berisha “Abeja” segmenti i rrugës “Rifat Banjska”*”.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit gjenë bazë në nenin 62, paragrafi 1, nënparagarafi 1.1, i cili citon: “*1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:*

1.1.një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.”

Po ashtu, Paneli Shqyrtues konstaton se me rastin e përpilimit të Dosjes së Tenderi, AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së dhe nenit 18, paragrafi 18.4 të RRUOPP, i cili citon: “*Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratës në fjale që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tillë do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkësat, kriteret, afatet kohore, metodologjitet, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është*

materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sinqeruese shtesë”.

Paneli shqyrtues, nëse evidenton se zyrtari përgjegjës i prokurimit, në të ardhmen, bënë gabime tjera të mëdha, sikur ky, dhe patjetër aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet si rrjetohojë e gabimeve të tij, atëherë me një shkresë do ti drejtohet KRPP-së, dhe do të kërkojë që të veprojë konform nenit 25 të LPP-së.

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Bazuar në të lartësuarat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Z. Vedat PATERQOI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna Vushtrri;
- 1x1 OE- “EL BAU” SH.P.K- Gjilan”;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb-faqe të OSHP-së.